REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 75/17
Datë/Datum. 04.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

---

**PSH. nr. 75/17**

**PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT,** i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Goran Milenkovič - Kryetar, z. Tefik Sylejmani - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues në konsorcium "Arlindi Sh.p.k & Berisha Company Sh.a" - Ferizaj, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, me titull: "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në regjion e Gjilanit- zonat Rurale", Lot 1, me nr prok: "2016/016/521", i iniciuar nga autoriteti kontraktues / KRU Hidromorava Sh.a /, më datën 21. 04. 2017, mori këtë:

**V E N D I M**

I. **Aprovohet,** pjesërisht si e bazuar ankesa e konsorciumit "Arlindi Sh.p.k & Berisha Company Sh.a" – Ferizaj, kundër njoftimit për anulim të aktivitett të prokurimit me titull: "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në regjion e Gjilanit- zonat Rurale" Lot 1, me nr prok: "2016/016/521", i iniciuar nga autoriteti kontraktues / KRU Hidromorava Sh.a /.

II. **Vërtetohet,** vendimi i AK /KRU Hidromorava Sh.a/, për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në regjion e Gjilanit - zonat Rurale" Lot 1, me nr prok: "2016/016/521", ndërsa nëse autoriteti kontraktues ka interes edhe mëtutje për këtë aktivitet të prokurimit t'a ritenderoj.

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Konsorciumit ankues "Arlindi Sh.p.k & Berisha Company Sh.a" – Ferizaj, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa është aprovuar si pjesërisht e bazuar.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 e rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me datën: 27.12. 2016.

Hapja e ofertave është paraparë të bëhet me datën: 19.01.2017, ku kanë marr pjesë shtatë (7) operatorë ekonomik.

Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit është bërë me datën 02.03.2017

Kundër njoftimit për anulim të këtij aktiviteti, Konsorciumi "Arlindi Sh.p.k & Berisha Company Sh.a" – Ferizaj me datën: 27. 02. 2017, kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Konsorciumi "Arlindi Sh.p.k & Berisha Company Sh.a" – Ferizaj, si palë të pakënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, më datën 15 Mars 2017 me nr. 75/17, kundër njoftimit për anulim, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në regjion e Gjilanit- zonat Rurale", me nr prok: "2016/016/521", duke pretenduar se autoriteti

kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 23 mars 2017, i ka rekomanduar panelit shqyrtues që të aprovoj si të bazuar ankesën e OE "Arlindi & Berisha Compani" sh.p.k, me seli në Ferizaj, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të anuloj vendimin "Njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit, i datës 03.03.2017, me titull: "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në regjionin e Gjilanit – zonat rurale Lot-1", me nr. prokurimi: KRU2016/016/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KRU HIDROMORAVA SH.A – GJILAN, dhe lënda të kthehet në Rivlerësim për Lot-1.

Konsorciumi "Arlindi Sh.p.k & Berisha Company Sh.a" – Ferizaj, me datën: 04 prill 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues "KRU Hidromorava" sh.a – Gjilan, me datën 05 prill 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 21.04.2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesit e palëve në procedurë, vëzhgues nga OJQ D Plus, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik ankues "Arlindi & Berisha Company", ka deklaruar: "Të gjitha pretendimet tona ankimore janë të cekura në ankesën tonë".

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK- "KRU Hidromorava", ka deklaruar: "Dua të bëjë një plotësim se DORSH CDI janë bartës të projektit, lidhur me këto që u thanë, në parim kur jam njoftuar për përgjigjen e DORSH CDI dhe arsyet e tyre, personalisht nuk jam pajtuar, pasi OE-të që kanë aplikuar kanë qenë brenda planit-buxhetit. Mirëpo një diçka që realisht duhet të cekët është se veç është bërë hapja, është mbyll procesi pa bërë vlerësim. Ndërkohë janë parë disa të meta-plotësime shumë serioze në dosje, dhe është kërkuar të plotësohet dosja dhe në këtë pikë jemi pajtuar plotësisht pasi që projekti ka nevojë të plotësohet pasi janë harruar në paramasë dy sisteme të rëndësishme të rehabilitimit, është për komunën e Kllokotit, zhitia dhe ka pas edhe për pjesë tjera për ripërpunim dmth ka ndryshime rrënjësore për paramasë që për neve është e arsyeshme. Ne në parim kompanitë që kanë konkurruar janë serioze përfshirë edhe OE ankues, mirëpo çështja e anulimit që është kërkuar është kjo arsyeja kryesore që ceka më herët.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues i OSHP-së, ka deklaruar: "Këtu ka qenë pretendim ankimor kundër anulimit, arsyeja e AK-së për anulim nuk qëndron dhe këtë e konfirmoj edhe vet përfaqësuesi i AK-së, për faktin se në arsyetimin e anulimit thuhet se është tejkaluar buxheti për programin RESSP, e cila është arsye banale pasi nuk është tejkaluar edhe lehtë verifikohen çmimi i ofertës së OE dhe planifikimit në njoftim për kontratë. Arsyet që tani jep AK nuk i kemi të njohura pasi nuk janë të shkruara në dokumentacionin dhe i mbetet panelit shqyrtues të vlerësoj pretendimet e AK-së lidhur me arsyet e që përfaqësuesi i AK potencoj në seancë.

Gjatë seancës Anëtari i panelit shqyrtues z.Sylejmani ka pyetur përfaqësuesin e AK-së, se ky projekt a mundet të vazhdojë pa këto dy komuna, të zhvillohet ndaras ?

Përfaqësuesi i AK-së në përgjigje ka deklaruar: "Ne nuk vendosim për këto dy komuna pasi siç cekëm donator për këtë projekt është dikush tjetër, dhe aty janë 17 fshatra dhe këto dy që cekëm janë harruar".

Anëtari i njëjtë i panelit shqyrtues përsëri ka pyetur përfaqësuesin e AK-së se për këto dy fshatra që potenconi, a e tejkalojnë së bashku vlerën prej 10% të planifikimit buxhetor ?

Përfaqësuesi i AK-së në përgjigje ka deklaruar: "Po këto dy fshatra tejkalojnë 10% të vlerës së projektit".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues "Arlindi & Berisha Company" ka deklaruar: "Pretendimet e AK nuk qëndrojnë pasi që punët që thuhet se duhet bërë në dy komuna nuk kanë qenë fare paramasë, dhe thuhen se nga AK-ja si dramatizim i çështjes pasi nuk janë

paraparë në projekt. Kjo po ashtu nuk qëndron pasi që tani mund të rrisim vëllimin e punëve me fjalë, mirëpo kjo nuk ka qenë asnjëherë pjesë e dosjes. Gabimi në paramasë nuk qëndron me arsyetimin që jep AK tani, a ka qenë paramasa gabim apo jo nuk dimë dhe ai OE që AK thotë se ka bërë vërejtje nuk ka dorëzuar tender. I propozojmë panelit shqyrtues që të aprovohet ankesa jonë si e bazuar dhe sipas rekomandimit të ekspertit të kthehet lënda në Rivlerësim".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK- "KRU Hidromorava", ka deklaruar: "Projekti dhe paramasa është bërë sipas një studimi prej kompanisë më herët dhe nga ajo ka ardh edhe paramasa, dhe komplet ai studim mund ti ofrohet panelit si dëshmi ku në atë studim janë edhe dy fshatrat të cilat janë harruar të futen në dosje të tenderit".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi tjetër i AK-së ka deklaruar: "Pretendimi i OE nuk qëndron plotësisht dhe mund të dëshmojmë se një kompani para afatit të dorëzimit të ofertave na ka tërheq vërejtjen për mungesa në dosje të tenderit, konkretisht se kemi mungesa në sasi. Ne i jemi përgjigjur se mund të dorëzoj ofertë pasi kjo ka qenë rekomandim i CDI në atë kohë. I rekomandojmë panelit shqyrtues që të vërtetojë vendimin e AK-së për anulim të këtij aktiviteti dhe të lejoj AK të kthej lëndën në Ritender pasi dy sisteme të rëndësishme mungojnë nga projekti me këtë dosje për këtë aktivitet të prokurimit".

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve në procedurë vjen në përfundim se autoriteti kontraktues e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit duke u bazuar në shkresën e CDI (si investitor) të datës 27 shkurt 2017 ku është shënuar, citojmë "*Ne e kemi shikuar tenderin i cili është publikuar nëpërmjet KRPP-së dhe jemi të shqetësuar se sasitë e e përfshira në dokumentet e tenderit janë të tepërta në krahasim me vlerësimin teknik dhe e tejkalojnë buxhetin në dispozicion të Programit RWSSP-V. Për këtë arsye, ju duhet të anuloni tenderin aktual dhe ti rishikoni edhe një herë sasitë para se ta ritenderoni punën që duhet të bëhet. Ju lutem që paraprakisht të konsultoheni me ne dhe të merrni aprovimin për punët që do të realizohen në mënyrë që të mos ketë tejkalime buxhetore*".

Prandaj paneli shqyrtues duke pasur parasysh se investitor është CDI dhe duke pasur parasysh shkresën e lartpërmendur, si dhe duke u bazuar në faktin se autoriteti kontraktues nuk ka mjete vetanake për realizimin e këtij projekti, vjen në përfundim se autoritetit kontraktues me të drejtë e ka anuluar këtë procedurë të prokurimit. Paneli shqyrtues me rastin e marrjes së këtij vendimi pati parasysh edhe sqarimin e përfaqësuesit të autoritetit kontraktues, se në dosje të

tenderit duhet bërë plotësime të tjera e që kanë të bëjnë me ndryshimet rrënjësore në paramasën në dy sisteme të rëndësishme të rehabilitimit edhe për dy fshatra, e që e tejkalojnë edhe më shumë vlerën e planifikimit buxhetor.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Zr. Goran MILENKOVIĆ

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "KRU Hidromorava Sh.a"

1x1 OE – "Arlindi Sh.p.k & Berisha Company Sh.a" - Ferizaj

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.